



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201601923/4

Lënda : Rekomandohet marrja e masave ligjore për shpejtimin e procedurave gjyqësore, të gjykimit të dosjes penale me Nr.00042 akti datë 13.01.2016, me të pandehur E.G.

Drejtuar : Z.Rudin BAQLI
Kancelar i Gjykatës së Lartë

TIRANË

I nderuar zoti Baqli,

Në ankesën e tij datë 23.09.2016, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Sh. G. nga qyteti i Korçës, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje penale nga Gjykata e Lartë Tiranë ndaj djalit tij Ermal Gora i cili është gjykuar dhe dënuar me 10 vjet burgim për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake. Kështu provohet se me vendimin penal me Nr.1882 datë 02.06.2014 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë, ai është deklaruar fajtor për krimin e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal e ka dënuar me 10 vjet burgim.

Ankuesi Sh. G. nga ana e tij na shkruan se ndaj këtij vendimi gjyqësor është ankuar në shkallën e dytë në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin e saj me Nr.329 datë 30.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me Nr.1882 datë 02.06.2014 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë.

Tani ndaj këtyre dy vendimeve gjyqësore djali i tij E. G. ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, dhe dosja e tij tani ndodhet e regjistruar për gjykim me Nr.00042 akti datë 13.01.2016, dhe si Relator është caktuar Z.Tom NDRECA dhe ankuesi ka kërkuar shpejtim gjykimi duke patur parasysh arsyet shëndetësore se djali i tij është duke kaluar nga disa sëmundje të ndryshme që kanë keqësuar shumë gjendjen e tij shëndetësore.

Po kështu ankuesi Sh. G. na shkruan se dispozitat e nenit 278 të Kodit Penal janë shfuqizuar me vendimin Nr.9 datë 26.02.1916 nga Gjykata Kushtetuese e cila në përfundim të gjykimit ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014.

Kuvendi i Shqipërisë, nga ana e tij ka miratuar Ligjin me Nr.82/2016 "Për disa ndryshime në Ligjin me Nr.7895, datë 27.01.1995,"Për Kodi Penal i

Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në nenin 278/4 të tij thuhet se mbajtja e armëve shpëthyesë ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Në këto kushte dhe rrethana duke analizuar në unitet të gjitha kërkesat e ankuesit Sh. G. dhe faktin tjetër se ato janë në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga administrata publike”, dhe kërkesat e neni 25 të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se:”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”. Mendojmë që ky rast nga ana juaj të trajtohet si ***rast i veçantë*** dhe të shikohen mundësit ligjore për shpejtimin e tij duke patur parasysh edhe kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH mbi të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm.

Sa më sipër, ju

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes penale me Nr.00042 akti datë 13.01.2016, me të pandehur shtetasin E. G.

2.Mbi masat e marra për shqyrtimin e këtij rekomandimi nga ana juaj lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

ARBEN SHKËMBI